



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 43, datë 01/10/2004

**“MBI  
DISA NDRYSHIME NË BUXHETIN E BASHKISË TIRANË  
PËR VITIN 2004”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 19, pika 5 dhe 9, neni 32, gërma “dh”, ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993, “Për buxhetin lokal”, neni 18 dhe 21, ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10/03/2004 “Për miratimin e realizimit të buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2003 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2004”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.444, dt.05/09/1994, bazuar në relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I;**

1. Të miratojë një shtesë në limitin e të ardhurave për shpenzime në shumën prej 25.306.000 lekës, sipas Tabelës Nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë financimin e investimeve në shumën prej 11.432.400 lekësh, sipas Tabelës Nr.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi, duke rritur limitin e të ardhurave për investime në shumën prej 7.090.400 lekësh.
3. Efektet financiare për zbatimin e pikës 1 të këtij vendimi të përballohen nga Fondi rezervë nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, për vitin 2004 në shumën prej 25.306.000 lekësh.
4. Efektet financiare për zbatimin e pikës 2 të këtij vendimi të përballohen:
  - në shumën prej 7.090.400 lekësh duke pakësuar Fondin Rezervë nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, për vitin 2004,
  - në shumën 3.000.000 lekësh, duke pakësuar zërin “Blerje pajisjesh” për Qendrën Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve,
  - në shumën prej 1.342.000 lekësh duke pakësuar zërin “Garanci Punimesh 5%” për Drejtorinë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit për objektet “Restaurimi dhe

lyerja e fasadave tek Pallatet Agimi dhe Shallvaret” dhe “Fasadat e Rr. së Kavajës.....”, nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për vitin 2004.

5. Të miratojë ndryshimin e përdorimit të fondit të investimeve për “Studime Urbane” në shumën 15.000.000 lekë, në investime për “Përgatitjen e hartave digitale dhe sistemit G.I.S, të planit të përgjithshëm rregullues të qytetit të Tiranës” në shumën prej 15.000.000 lekë.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve & Burimeve Njerëzore dhe Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**